

Pse Krijuesi kërkon të shpëtojë gjithë jetët

Pse Krijuesi kërkon të shpëtojë të gjitha jetët? Kjo është për shkak të dashurisë së Tij ndaj tyre dhe sepse është Ai që u dhuroi atyre jetë.

Gjatë kësaj faze të fundit të ciklit të Formimit, Stabilitetit, Degjenerimit dhe Shkatërrimit të kozmosit, Krijuesi shpenzoi 200 milionë vjet për të krijuar Tre Mbretëritë, si dhe duke planifikuar dhe vendosur mënyrat dhe mundësitë e shumta me anë të të cilave mund të shpëtoheshin jetët, ndërsa në të njëjtën kohë hidhte një themel për kulturën, mendimin dhe sjelljen e njerëzimit. Ai për më tepër përdori trupin e Tij hyjnor për të reduktuar dhe zgjidhur karmën mëkatore të morisë së jetëve! Ai ka dhënë gjithçka të Tijën për të shpëtuar gjithë jetët.

Gjatë këtyre 200 milionë viteve, Krijuesi u ringjall me trupa të shumtë në të njëjtën kohë, një numër i pa numërueshëm, dhe hodhi themelet për kulturën e njerëzimit në këtë botë ndërsa mbikëqyrte dhe ruante moralin e njerëzimit; kjo u bë që njerëzit, një ditë—kur, gjatë Fundit të Kohëve, të vinte epoka e shpëtimit—të përmbushnin standartin e vendosur për ta nga qeniet hyjnore. Shpirtrat e njerëzve janë ringjallur në mënyrë të përsëritur gjatë epokave të gjata dhe të zgjatura të historisë dhe kanë kaluar dhjetëra miliona vjet në pritje. Me kalimin e kohës, trupat e vërtetë të shpirtrave të shumicës së njerëzve në botë (dhe kjo vlen për të gjitha etnitë dhe racat) vendosën një formë lidhjeje familjare me Krijuesin. Kjo e bëri Krijuesin t'i donte njerëzit e botës, njerëzit e Tij, akoma më shumë. Me ardhjen e Fundit të Kohëve, u ndalua që jetët pa një lidhje të tillë të bëheshin njerëz; kjo u bë për të siguruar që sipërmarrja e shpëtimit të mund të përmbushej më mirë. Në atë kohë, trupat e vërtetë të njerëzve në këtë Tokë ishin të gjithë ata të popullit të Tij. Po kështu ishin edhe qeniet hyjnore në të cilat besojnë njerëzit, të cilët u ringjallën si qenie njerëzore dhe shërbyen për të dhënë mësim shpirtëror. Misioni i tyre ishte që duke marrë formë njerëzore, të vendosnin themelin kulturor të synuar nga hyjnorja për shpëtimin e njeriut në fund nga Krijuesi. Fetë e virtytshme dhe autentike që ata lanë në këtë botë kanë vazhduar me qëllim që të mbrojnë moralin ndërsa njerëzit presin shpëtimin e tyre përfundimtar nga Krijuesi. Krijuesi ka të drejtë të dojë popullin e Tij dhe dashuria e Tij është edhe më e madhe për ata që Ai i konsideron se e meritojnë dashurinë. Ai ka të drejtë ta bëjë këtë dhe askush apo asnjë krijesë nuk ka të drejtë të ndërhyjë! Ky është mëshirimi i Tij suprem ndaj këtyre jetëve!

Krijuesi është Zoti i të gjitha qenieve hyjnore në Kozmos. Ai është krijuesi i Zotit të zotërve, i Mbretit të mbretërve dhe Ai është Sovrani i të gjitha jetëve—përfshirë jetët njerëzore të Tre Mbretërive, qeniet shpirtërore dhe gjërat materiale, të gjitha këto që Ai i krijoi. Dashuria e Tij është bekimi më i lartë dhe më i shenjtë për të gjitha jetët! Nuk ka nder më të madh për asnjë person në këtë botë sesa të duhet prej Tij!

Mësuesi Hongzhi Li
17 prill, 2023